



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 276 . Dt 30/12/24

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE TË OFK-SË

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1, nenit 61 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Nenit 21 paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OFK-së nr. 134 të datës 04/06/2024, në mbledhjen e mbajtur me 14/12/2024, nxjerrë këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE

Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e menaxhimit të mjeteve financiare të Odës së Farmacistëve të Kosovës (në vazhdim) Oda duke përfshirë përcaktimin e mënyrës së planifikimit të buxhetit, mënyrës së shpenzimit, autorizimet për urdhër të ekzekutimit të mjeteve financiare dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me menaxhim të financave.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për menaxhimin e financave të OFK-së në burim sipas të ardhurave që janë të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.
2. Rregullorja për menaxhimin e financave të OFK-së nuk zbatohet tek të hyrat financiare, të cilat burim kanë fonde nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Shpenzimi i këtyre fondeve bëhet bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra nga Qeveria e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat dhe akronimet të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Komisioni për Buxhet dhe Financa** – nënkupton komisionin e përhershëm të Odës;

- 1.2 **Komisioni përfurnizim** – nënkupton Komisionin e themeluar nga Këshilli Drejtues i OFK-së për zhvillimin e procedurave të aktiviteteve furnizuese;
 - 1.3 **Buxheti** – akt i miratuar nga Kuvendi i Odës me të cilin bëhet planifikimi financiar në periudhë vjetore;
 - 1.4 **Transaksioni** – nënkupton veprimet si pagesat, qoftë me para të gatshme apo përmes bartjes me ndërmjetësim bankar, barazimi, dakordimi, marrëveshjet për pagesat dhe kompensimet përfundët dhe shërbimet e caktuara;
 - 1.5 **Raporti Financiar** – pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhë të caktuar;
 - 1.6 **Cash Floë** – pasqyra financiare që shërben përfundët e evidentuar të gjitha lëvizjet (hyrjet dhe daljet) në arkë dhe bankë.
2. Termat dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Neni 4 **Burimet financiare të Odës**

1. Burimet themelore financiare të OFK-së në bazë të të cilave mbështetet struktura financiare, janë si në vijim:
 - 1.1 Të hyrat nga pagesa e kuotës së anëtarësisë;
 - 1.2 Të hyrat nga taksat administrative përfundët licencim dhe rilicencim si dhe shërbime të tjera administrative;
 - 1.3 Të hyrat nga ekzekutimi i masës disiplinore të dënimit me të holla ;
 - 1.4 Të hyrat nga donacionet;
 - 1.5 Të hyrat nga organizimi i EVP-së,
 - 1.6 Të hyrat nga projektet e subvencionuara; dhe
 - 1.7 Burime të tjera financiare që mund të realizohen nga afarizimi publik i Odës.
2. Oda mund të realizojë të hyra edhe nga fondet publike të Republikës së Kosovës sipas destinacionit të paracaktuar financiar.
3. Të hyrat nga paragrafi 2 i këtij neni menaxhohen në përputhje me Ligjin përfundët Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë dhe të njëjtat nuk ekzekutohen sipas bazës juridike të përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 5 **Buxheti i Odës**

1. Kuvendi i Odës miraton Buxhetin vjetor, çdo vit si pjesë e planit dhe programit vjetor, deri në fund të dhjetorit të vitit aktual për vitin pasardhës.
2. Buxheti i miratuar i OFK-së duhet të përmbajë:
 - 2.1 Planifikimin e të hyrave financiare;
 - 2.2 Përllogaritjen e shpenzimeve të domosdoshme të përcaktuara sipas destinacionit dhe atë:
 - 2.2.1 Investimet kapitale;
 - 2.2.2 Shpenzimet operacionale;
 - 2.2.3 Pagat dhe mëditjet.
 - 2.3 Përcaktimin e shumës buxhetore për shpenzime të paplanifikuara.
3. Këshilli Drejtues i Odës nxjerrë vendim për rialokimin e mjeteve nga një linjë buxhetore në linjën tjetër sipas nevojës, i cili nuk duhet të tejkalojë më shumë se 10% të shumës bazë të përcaktuar nga Kuvendit.

Neni 6 **Afati për procedimin e Projektbuxhetit**

1. Kryetari i OFK-së e përgatit për procedim Projektbuxhetin e Odës në bashkëpunim me komisionin për buxhet dhe financa dhe kordinatoreni e departamentit për financa, më së largu deri në javën e fundit të muajit nëntor të vitit vijues për vitin e ardhshëm, dhe të njëjtin ia procedon Këshillit Drejtues.
2. Këshilli Drejtues jo më larg se 30 (ditë) nga parashtrimi i projektbuxhetit shqyrton propozimin dhe në rast të miratimit e procedon atë tek Kuvendi për miratimin përfundimtar.
3. Kuvendi i Odës duhet ta miratojë Projektbuxhetin më së voni deri më datë 31 dhjetor të vitit vijues për vitin e ardhshëm.
4. Në rast se Kuvendi i Odës dështon që ta miratojë Projektbuxhetin e propozuar apo nuk e shqyrton deri në fund të vitit, afati për miratim zgjatet deri me datë 31 mars të vitit të ardhshëm.

5. Gjatë periudhës së afatit të zgjatur për miratim sipas paragrafit 4 të këtij neni, mjetet financiare do të ekzekutohen sipas Buxhetit të vitit paraprak.
6. Nga ekzekutimi i destinimeve buxhetore nga viti paraprak sipas paragrafit 5 të këtij neni, përjashtohen vijat buxhetore përkitazi me investimet kapitale që janë paraparë me buxhetin e vitit paraprak.
7. Në rast të dështimit të miratimit të buxhetit deri në afatin e zgjatur (31 Mars), buxheti i vitit paraprak do të zbatohet duke përfshirë përjashtimet e përkufizuara me paragafin 6 të këtij neni deri në përfundimin e vitit buxhetor.

Neni 7

Mënyra e parashtrimit të propozimeve për ndryshime në projektbuxhet

1. Projektbuxheti i dërgohet anëtarëve të Kuvendit të Odës në afat prej 10 (dhjetë) ditëve para mbajtjes së seancës së Kuvendit të Odës.
2. Anëtarët e Kuvendit të OFK-së mund t'i parashtronë propozimet e tyre në formë të shkruar jo më vonë se 4 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit të OFK-së. Propozimet e paraqitura pas afatit të përcaktuar me këtë paragraf nuk do të procedohen për shqyrtim në Kuvendin e OFK-së.
3. Propozimet e dërguara nga anëtarët e Kuvendit të OFK-së do të shqyrtohen nga Këshilli Drejtues para seancës së thirrur të Kuvendit të OFK-së.
4. Rekomandimet e Këshillit Drejtues lidhur me propozimet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të OFK-së do të prezantohen nga Kryetari në seancën e Kuvendit të OFK-së.
5. Të gjitha propozimet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit do të votohen si amendamente të veçanta me apo pa përkrahjen e Këshillit Drejtues, nëse nuk kalon propozimi i Këshillit Drejtues për buxhetin
6. Në rastet kur nga anëtarët e Kuvendit parashtronen propozimet që ndryshojnë destinimin e projektuar finanziar në më shumë se 2/3 e shumës së përgjithshme buxhetore, Kuvendi i Odës ia kthen Zyrtarit të lartë administrativ për riprojektim, Projektbuxhetin.

Neni 8
Ekzekutimi i buxhetit

1. Buxheti i OFK-së ekzekutohet sipas projekzionit të miratuar nga Kuvendi i OFK-së, siç është paraparë me dispozitat e nenit 5 të kësaj rregulloreje.
2. Kryetari i OFK-së ka autorizim për aprovimin e shpenzimeve deri në vlerë prej 2,000.00 € brenda muajit.
 - a) Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve mund të paraqitet nga organet e OFK-së apo shërbimi profesional.
3. Për shpenzimet që tejkalojnë shumën të përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, Këshilli Drejtues i OFK-së aprovon shpenzimin për nevojat e parapara me buxhet.
4. Me rastin e furnizimit, shfrytëzimit të shërbimit apo shpenzimeve që janë në shërbim të OFK-së dhe tejkalojnë vlerën prej 2,000.00 €, Këshilli Drejtues do të sigurojë të paktën 3 (tri) oferta nga ofertuesit sipas ftesës për ofertë.
5. Përjashtim nga paragradi 4 i këtij neni, në rast se furnizimi apo shërbimi i nevojshëm ka afilitete të veçanta që nuk mund të ofrohen nga operatorë të tjerë ekonomikë, Këshilli Drejtues mund të përzgjedhë furnitorin apo shërbimdhënësin edhe pa u siguruar 3 (tri) oferta të operatorëve ekonomikë,
 - a) Për organizimin e aktiviteve të EVP-së, si përcaktimi i vendit të mbajtjes së tyre dhe shpenzimeve ndërlidhëse për shkak të vecantisë së procesit mund të zhvillojë procedurën e negociuar me dy opertorë duke përfshirë edhe operatorin nga organizmi paraprak.
6. Për nevojat e përcaktuara sipas paragrafëve 4 të këtij neni, Këshilli Drejtues do të caktojë Komisionin për Furnizim dhe Shërbime i përbërë prej 3 (tre) anëtarëve të KBF. Komisioni ka kryesuesin i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komisionit.
7. Komisioni për furnizim dhe shërbime pas zhvillimit të procedurave për përzgjedhje të ofertave do të përgatisë raportin i cili do t'i paraqitet për aprovim Këshillit Drejtues.

Neni 9
Kriteret për përzgjedhjen e operatorit ekonomik

1. Komisioni për furnizim dhe shërbime me rastin e pranimit të së paku 3 (tri) ofertave të operatorëve ekonomikë, përzgjedhjen e ofertës do ta bëjë në bazë të këtyre kritereve, nëse me nenet paraprak nuk është paraparë ndryshe:
 - 1.1 Oferta më e favorshme ekonomikisht;
 - 1.2 Çmimi më i ultë i ofruar; dhe
 - 1.3 Konformiteti cilësor i furnizimit apo shërbimit të ofruar.
2. Komisioni për furnizim dhe shërbime me rastin e përzgjedhjes do t'i japë përparësi konformitetit cilësor, duke u mbështetur në arsyeshmërinë e çmimit të ofruar nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë rregullorë.

Të hyrat nga taksat administrative

Neni 10 **Taksat administrative**

1. Në cilësi të të hyrave të cilat gjenerohen me rastin e ofrimit të shërbimeve administrative të ofruara nga OFK-ja përmes Shërbimit Profesional dhe komisioneve gjegjëse, përfituesit e shërbimeve të tillë do të paguajnë shumën e caktuar të parave në emër të taksës administrative.
2. Lartësia e taksave administrative përcaktohet me shtojcën A të kësaj rregullore, ndërsa lartësia e pagave, shtesave dhe mëditjeve për anëtarët e organeve të OFK-së me shtojcën B.
3. Pagat e shërbimit profesionale përcaktohet me rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të miratuar nga Këshilli Drejtues.
4. Taksat administrative paguhen në xhirologarinë e Odës përmes transaksionit bankar.

Neni 11 **Evidentimi i transaksioneve**

1. Transaksionet e autorizuara sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore evidentohen në momentin e ekzekutimit (përllogaritjes).

2. Menaxhimi i kontabilitetit financier kryhet përmes shfrytëzimit të softuerit, i cili mundëson përdorimin e sistemit sipas SNK. Zyrtari i ngarkuar për kontabilitet është i autorizuari i zyrtarit të lartë administrativ për përdorimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e sistemit të kontabilitetit sipas standardit të përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 12
Llogaria bankare

- I. OFK-ja ka llogarinë e saj bankare që paraqet llogarinë kryesore në të cilën deponohen mjetet financiare që konsiderohen si burimet themelore të OFK-së.
- II. Për nevojat që janë në përputhje me këtë rregullore, OFK-ja mund të hapë edhe nënllogari të tjera bankare.
- III. Bartësi kryesor i llogarisë bankare është Kryetari i OFK-së
- IV. Kryetari i OFK-së ka kompetencë që ta bartë pjesshëm autorizimet e tij në raport me menaxhimin e llogarisë sa i përket ekzekutimit sipas urdhrit financier të dhënë nga ai.

Neni 13
Urdhri për ekzekutim financier

1. Të gjitha transaksionet e miratuara do të ekzekutohen sipas urdhrit nga Kryetari i OFK-së
2. Urdhri për ekzekutim të transaksionit mund të përbajë autorizimin për ekzekutim nga zyrtari financier i angazhuar pranë OFK-së.
3. Të gjitha urdhrat ekzekutive për transaksione financiare duhet të ruhen së bashku me fletëpagesat dhe faturat e rregullta lidhur me transaksionet gjegjëse. Për ruajtjen e të njëjtave është i obliguar zyrtari financier i angazhuar në OFK.

Neni 14
Arka

1. Zyrtari financier do të jetë i autorizuar që të ruajë në kasafortë të OFK-së para të gatshme në shumë prej 500 € por jo më shumë se 1000 € brenda vitit.
2. Paradhëniet nga vlera e caktuar me paragrafin 1 të këtij nenit ekzekutohen me aprosim të zyrtarit të lartë administrativ.

3. Shpenzimet me para të gatshme për një transaksion të vetëm mund të bëhen deri në shumë prej 100.00 €. Çdo pagesë përtej shumës së tillë duhet të bëhet përmes transaksionit bankar.
4. Shpenzimet nga ky fond gjithashtu duhet të ruhen dhe të mirëmbahen nga zyrtari finansiar i OFK-së në Cash Floë.

Menaxhimi i sistemit të pagave

Neni 15 Evidenca e të punësuarve

Zyrtari i financave mban evidencën e të punësuarvc pranë Shërbimit Profesional të OFK-së, duke përfshirë arkivimin e Kontratave të Punës, evidencën e pagave dhe mëditjet si dhe parapagesat e parashtruara për aprovim, përfshirë ato të aprovuara dhe të refuzuara.

Neni 16 Ekzekutimi i pagave

1. Në rastet e ekzekutimit të pagave të personave të angazhuar me mandat të zgjedhur, paga bëhet në bazë mujore në periudhë më të largët prej 5 (pesë) ditëve të muajit të ardhshëm kalendarik.
2. Për të gjithë të punësuarit përgatitet pasqyra e pagave në të cilat paraqitet paga neto, mëditjet, zbritjet e mundshme, detyrimet fiskale, kontributet dhe kalkulimet e benificacioneve të parapara me legjislacionin në fuqi.
3. Në pasqyrë të tillë të pagave përfshihet edhe pagesa e mëditjeve të anëtarëve të organeve të OFK-së.
4. Këshilli Drejtues i OFK-së mund të caktojë shpërblim shtesë për të angazhuarit me punë pranë OFK-së.

Mëditjet dhe kompensimi i shpenzimeve të tjera

Neni 17 Mëditjet

1. Anëtarët e organeve të OFK-së gjëzojnë të drejtën e kompensimit të mëditjeve për angazhimin e tyre në organet gjegjëse të OFK-së.
2. Lartësia e mëditjeve të anëtarëve të OFK-së do të përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të OFK-së që propozohet nga Kryetari i OFK-së.
3. Të punësuarve pranë Shërbimit Profesional të OFK-së do t'u kompensohet puna jashtë orarit të rregullt të punës sipas vendimit të vecantë të Këshillit Drejtues.
4. Evidentimi i transaksioneve financiare në emër të mëditjeve dhe pagesës shtesë do të bëhet në përputhje me mënyrën e përcaktuar me këtë rregullore.
5. Përgjegjës për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e ekzekutimit të transaksioneve të tillë është zyrtari finanziar i OFK-së.

Neni 18 **Shpenzimet e tjera**

1. Mjetet financiare të Odës përdoren për:
 - a) Mbështetje financiare anëtarëve të OFK në rast fatkeqësie apo sëmundje,
 - b) Organizim veprimtarish shkencore-profesionale (konferanca, simpoziume, sesione, seminare, trajnime, punëtori, etj.),
 - c) Botime me karakter shkencor e profesional për anëtarët e Odës,
 - d) Shpërblime për anëtarët e Odës,
 - e) Aktivitete të ndryshme kulturore të Odës,
 - f) Shpenzimet operative të Odës (nevojat për zyre, shpenzimet e komunikimeve telefonike, udhëtime zyrtare, derivate, transport, ndërlidhje, energji, etj.),
 - g) Investim dhe blerje mjetesh dhe pajisjesh pune,
 - h) Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, si dhe pritje e përcjellje delegacionesh të huaja,
 - i) Ceremoni të ndryshme përkujtimore, promovuese, etj.
2. Për lartësinë e mjeteve financiare nga paragrafi 1 i këtij neni vendos Këshilli Drejtues.
1. Këshilli Drejtues merr vendim të veçantë, do të aprovojë lartësinë e kompensimeve lidhur me shpenzimet e komunikimeve telefonike.
2. Shpenzimet e tillë do t'u kompensohen zyrtarit të lartë administrativ, zëvendëskrytarëve të OFK-së, Sekretarit të Përgjithshëm të Odës dhe zyrtarëve të Shërbimit Profesional
3. Përgjegjës për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e ekzekutimit të transaksioneve të tillë është zyrtari finanziar i OFK-së.

Neni 19
Mbikëqyrja financiare

1. Kryetari i OFK-së nëpërmjet përgjegjësit për kontabilitet dhe KBF përgatit raportin tremujor financiar, të cilin e procedon pranë Këshillit Drejtues për miratim jo më larg se 10 ditë nga kalimi i muajit të katërt.
2. Këshilli Mbikëqyrës i Odës mbikëqyrë operacionet financiare të Odës. Mbikëqyrja nga paragrafi paraprak kryhet së paku një herë në vit, para përgatitjes së raportit vjetor përfundimtar.
3. Raportet tremujore të miratuara nga Këshilli Drejtues i dërgohen për raportim pranë Kuvendit të OFK-së për raportim çdo 6 (gjashtë) muaj, respektivisht pas aprovimit të dy raporteve të njëpasnjëshme tremujore.
4. Auditimi i jashtëm i menaxhimit financiar bëhet së paku dy herë gjatë mandatit vit. Auditori i jashtëm caktohet nga Këshilli Drejtues në një proces te hapur dhe konkurruesh, bazuar në ligjin për kontabilitet, auditim dhe raportim financiar.
5. Auditimi i projekteve qe financohen nga donatoret bëhet sipas kërkesës së donatorëve

REGJISTRIMI I PAJISJEVE DHE INVENTARIT

Neni 20
Evidentimi, regjistrimi i mjeteve themelore

1. Çdo blerje e mjeteve themelore ruhet në dosje financiare nga përgjegjësi për financa
2. Zyrtari përgjegjës financiar e bën evidentimin e vendndodhjes dhe barkodimin e pajisjeve në Odë , duke mbajtur evidencë të veçantë në fajle të excelit për të bërë evidentimin dhe përllogaritjen e zhvlerësimit ku përfshihet do të përfshihen: emërtimi i mjetit themelor, data e blerjes, data e vënies në përdorim, vlera etj.
3. Asetet përcaktohen në bazë të shkallës apo viteve të përdorimit. Çdo aset që ka vlerë përdorimi më shumë se një vit duhet të trajtohet aset fiks (mjet kryesor apo inventar në përdorim), duke mos respektuar vlerën e asetit.

- Regjistri i aseteve protokolohet në gjdo fundvit.

Neni 21

Largimi nga përdorimi i mjetave themelore

Oda do të sigurojë që mjetet themelore të cilat nuk përdoren më tutje duhet të eliminohen. Eliminimi për këtë qëllim nënkupton shitjen, dhënen donacion apo largimin e pasurive të dëmtuara/jo-funksionale. Largimi i tyre duhet të autorizohet nga Këshilli Drejtues i Odës, i cili themelon komision të veçantë. Bazuar në raportin e komisionit,

Dispozitat përfundimtare

Neni 22

Hyrja në fuqi

- Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha vendimet e Kuvendit të OFK-së që janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
- Pjesë përbërse e kësaj rregullore janë edhe shtojca A përcaktimi i taksave për shërbimet administrative të OFK-së dhe shtojca B përcaktimi i pagave, shtesa dhe mëditjeve për anëtarët e organeve të OFK-së
- Kjo rregullore hyn në fuqi nga 1 Janari 2025.

Prishtinë 14/12/2024



Kryetari i OFK-së
Mr.Ph. Kadri Bytyqi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Bytyqi", is placed next to the title and name.

LARTËSISË SË TAKSAVE ADMINISTRATIVE NË OFK

I. Taksat administrative për anëtarësim

Të gjithë anëtarët e Odës për rrëthanat e mëposhtme janë të obliguar të paguajnë taksat administrative si në vijim:

1. Për regjistrim të anëtarësisë vjetore prej 50.00 € për të gjithë farmacisteve e vendit.
 - a. Anëtarët e rindërtuar të cilët anëtarësohen brenda 1 viti nga përfundimi i provimit të licecnimit lironen nga pagesa e anëtarësisë për vitin e parë
2. Për ri anëtarësim në regjistrin e anëtarësisë së Odës, në rastin kur është larguar nga regjistri i anëtarësisë nga mospërbushja e obligimeve, në shumën prej 100.00 € dhe taksat e papaguara për vitet paraprake
 - a. Anëtarët të cilët rianëtarësohen në OFK deri më datën 31/03/2024 nuk paguajnë taksën e paraparë në paragrin 2 prej 100 €.
3. Për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional apo për shkak të humbjes, dëmtimit të kartelës së anëtarësisë së Odës në shumën prej 10.00 €.
4. Me rastin e riregjistrimit përbushen të gjitha obligimet paraprake të anëtarit deri ditën e fshirjes nga regjistri.

II. Taksat administrative për licencim dhe rilicencim

1. Taksë administrative për dhënie të licencës së punës në shumë prej 100.00 € për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
2. Për ekzemplarin e dublifikimit të licencës së punës në shumën prej 20.00 €; (licencat e humbura, licencat e dëmtuara, licencat për lirim nga plastifikimi)
3. Për lëshim të faksimilit në shumën prej 20.00 €.
4. Për provimin profesional të rilicencimit në OFK
 - a. 500€ për anëtarët të cilët gjatë procesit kanë arritur të ndjekin më pak se 51 pikë
 - b. 250 € për anëtarët të cilët gjatë procesit kanë arritur të ndjekin më shumë se 51 pikë.



III. Taksat administrative në procedurën e mbikëqyrjes etike

1. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim brenda vendit në shumën prej 20.00 €.
2. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim jashtë vendit në shumën prej 30.00 €.
3. Taksat sipas pikës 1 dhe 2 janë të vlefshme në afat kohor prej 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit të certifikatës (vërtetimit).

IV. Taksat administrative për dhënien e lejes për hulumtime bio-mjekësore

I. Aplikuesit për dhënien e lejimit për hulumtime bio-mjekësore, persona fizik apo juridik, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:

1. Për anëtarë të OFK-së, qytetar të Republikës së Kosovës në shumën prej 100.00€;
2. Për jo-anëtarë të OFK-së, qytetarë të Republikës së Kosovës në shumën prej 350.00€;
3. Për persona juridik organizata profitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 400.00€

II. Organi kompetent i cili lejon hulumtimin, cakton taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar me paragrafin I të këtij nenit.

V. Taksat tjera

1. Per certifikata/vertetime tjera taksa administrative prej 10 Euro, me perjashtim te vertetimit te anetaresise dhe licences te cilat perfshihen ne taksat respektive te anetaresimit dhe licencimit.

VI. Zbatimi i taksave administrative

1. Taksa administrative për inicimin e procedurës nuk kthehen në rast se refuzimi i kërkesës së anëtarëit është bërë si pasojë e lëshimeve nga ana e tij.



SHTOJCA B

CAKTIMI E LARTËSISË SË PAGAVE , KOMPENZIMIN MËDITJET DHE BENIFICIONET TJERA PËR ORGANET E OFK-së

I. Lartësin e pagave, kompenzimeve dhe mëditjeve përcaktohet si më poshtë :

1. Kryetari i OFK-së - brazvlershëm me pagën bruto të specialistit të farmacistë në institucione publike - QKUK (sipas ligjit të pagave)
2. Zv. Kryetarët e OFK-së – barazvlershme me 1/3 e pagës së Kryetarit
3. Mëditje për anëtarët e Kuvendit - 100€
4. Mëditje për Kryetarin e Këshillit Drejtues – 80€
5. Mëditje për anëtarët e Këshillit Drejtues – 70€
6. Mëditje për Kryesuesit e Organeve të OFK - 50€
7. Mëditje për anëtarët e Organeve të OFK - 40 €
8. Meditje për delegimin në përfaqësim të OFK-së brenda vendit në rastet kur kompenzimi nuk bëhet nga insitucioni që është ftuar – 40 €
9. Këshillat shkencore, keshilli botues i revistes, komisioni per provim të barazvlershëm me mëditjet e anëtarit të Këshillit Drejtues
10. Komisione tjera me rendësi të vecantë sipas vendimit të Këshillit Drejtes mund të barazvlerësohen me mëditjen e Këshillit Drejtues

II. Të gjitha shumat e lartëcekura nga paragrafet 1 -10 ekezkutohen në neto.

III. Me hyrjen në fuqi të këtij shtojce shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëhershme që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative të Odës.



A handwritten signature in black ink is placed over the official seal.